

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fjala në Elbasan - VIDEO/ Berisha: 'Tirania mediatike' fsheh Shqipërinë e varfër dhe emigracionin, 1.1 milion shqiptarë janë larguar
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919192/video-berisha-tirania-mediatike-fsheh-shqiperine-e-varfer-dhe-emigracionin-1-1-milion-shqiptare-jane-larguar/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 17:10:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 16:59:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	137eb2f5298ef560182d41d9857cae3ec46eb40e044a41bc8a40b448f4cfc68
TEKSTI	988c83691482c5aad36472d704dfd3a4fcf1039de7cf7c4a74413ad1c3d2ad12
PAMJA	216913bb78f072f5fd6e90674c500042e84d31cb18826351e1126f5790d5d5b5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4a1a15cdfd7822e48ab401a180b992314bb394d8a2bf5baa2cedf147cbb048fc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4a1a15cdfd7822e48ab401a180b992314bb394d8a2bf5baa2cedf147cbb048fc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.



Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtarëve

**ENVER BYTYÇI**

Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!

LAJMI I FUNDIT**LIVE/ Foltorja e Ripërtëritjes me Kryetarin e PD-së, Sali Berisha, në Elbasan****më të lexuarat**

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



Mashtrimi me shëndetësinë falas: Shqipëria e dyta në Europë për koston e lartë



Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë




'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë



Akuzat për shefen e SHSH, Ndoja: Kjo është rënia e shtetit, është bashkuar me krimin



Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të Ramës



VIDEO/ Berisha: 'Tirania mediatike' fsheh Shqipërinë e varfër dhe emigracionin, 1.1 milion shqiptarë janë larguar

18:59, 25/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Kryetari i PD-së, Sali Berisha, gjatë fjalës në 'Foltoren e Ripërtëritjes' në Elbasan, akuzoi qeverinë se përmes propagandës, dezinformimit dhe manipulimit po fsheh problemet ekonomike e sociale të vendit.

'Ky regjim ka vendosur tiraninë mediatike mbi qytetarët shqiptarë. Të dezinformimit, të propagandës, të manipulimit', deklaroi Berisha. Ai përmendi emigracionin, gjendjen e pensionistëve dhe rritjen e çmimeve, duke pretenduar se qytetarët shqiptarë përballen me kosto të larta jetese dhe të ardhura më të ulëta krahasuar me vendet europiane.

Berisha u ndal edhe te çmimet e ushqimeve, duke thënë se sipas të dhënave që ai referoi, ato janë rritur me 3.2% në Shqipëri, kundrejt 0.2% në Europë. 'Gjashtë herë më shumë, shtatë herë më shumë, në Shqipëri?', u shpreh kreu i PD-së.

Pjesë nga fjala e kreut të PD, Sali Berisha:

Ne jemi një forcë politike e cila në kushtet aktuale duhet të jetë e hapur ndaj çdo vlerë të këtij qyteti dhe të këtij vendi. Jemi një forcë politike e cila sot strukturat e saj duhet t'i ketë më funksionale se kurrë, më moderne se kurrë.

Jemi një forcë politike anëtarët dhe mbështetësit e saj sot më shumë se kurrë duhet të vendosin një dialog intensiv me çdo qytetar të Elbasanit dhe të Shqipërisë. Mos harroni një gjë, se sot propaganda e këtij regjimi ka vendosur, ose ky regjim, ka vendosur tiraninë mediatike mbi qytetarët shqiptarë.

Të dezinformimit, të propagandës, të manipulimit. Kjo është e vërteta.

Të pyes unë ju, o miq të mirë, a i dëgjoni ndonjëherë të flasin për dëbimin e këtij kombi këta? A i dëgjoni ndonjëherë të flasin se si ne vetëm në 10 vite në hapësirën e Shengenit kemi emigruar 1 milion e 99 mijë shqiptarë? A i dëgjoni

ndonjëherë të flasin këta se një pensionist s'merr dot as një të tretën e ilaçeve që i duhen në një muaj? A i dëgjoni ndonjëherë të flasin këta për çmimet e ushqimeve, të cilat janë më të larta se në Itali, se në Greqi, se në Gjermani dhe se në Amerikë, për të cilët, për ata që kanë rroga pesë herë, dhjetë herë më të ulëta se qytetarët e këtyre vendeve?

Vite më parë një prift shëtitës kishte qenë në shumë vende, erdhi dhe në Shqipëri dhe shkruan, ishte viti '91. Këtu thotë, varfëria në këtë vend thotë, është e frikshme dhe shumë e dhimbshme. Por dhe kam parë vende po kaq të varfra në Afrikë edhe numëronte pikërisht ato Angolën, Ugandën.

Dallimi midis tyre është thotë se në Angola dhe Uganda dyqanet ishin plot, por njerëzit ishin me bark bosh.

Në atë kohë, për ironinë e fatit tonë, ne krahasoheshim në të ardhurat për frymë, i kishim të njëjta me Ugandën dhe Angolën, të tretët në botë me të ardhurat më të ulëta. Por thotë, ata i kishin dyqanet plot, këtu thotë dyqanet s'kanë asgjë.

Tani ne u bëmë me dyqane plot, dhe përsëri si Angola dhe Uganda. Ku njerëzit s'blejnë dot.

A mund të imagjinoni ju që qytetarët me rrogat më të ulëta dhe pensionet më të ulëta të kenë naftën më të shtrenjtë në Europë? A mund të imagjinoni ju që nga viti i kaluar në këtë vit çmimi i ushqimeve të rritet, çmimi i kafshatës, të rritet në Shqipëri 3.2%, të rritet në Europë 0.2%? Gjashtë herë më shumë, shtatë herë më shumë, në Shqipëri?

© SYRI.net

Lexo edhe:



Berisha: U deklaroi organizatave kriminale të Elbasanit, Durrësit, Shkodrës dhe mbarë Shqipërisë, vend mbi tokë nuk do të keni veç burgut



118 ditë rezistencë popullore – Skandalet e reja, protestuesit kërkojnë dorëheqjen e Ramës dhe qeverisë së tij



'Ngjyra blu, ngjyra e shpresës'/ Alizoti: Rrënja e mirë prodhon risi të mirë! PD ka nevojë për qëndrestarët dhe të rinjtë

Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026

Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

TË NGJASHME



Bianka Çopja: Partia Demokratike e kaloi oqeanin, tani duhet të jetë uragani që përmbys korrupsionin



VIDEO- 'Dyqanet plot, xhepat bosh'/ Berisha: Pensionistët nuk blejnë dot ilaçet, regjimi i Ramës po shkatërron Shqipërinë



Të mos ketë derë të mbyllur për të rinjtë'/ Narazani: Ripërtëritja e PD ka nisur, Elbasani është dëshmia



VIDEO/ Berisha: Vezë mbi Padrinon në New York! Dënoj me forcë sharjet e Ramës ndaj diasporës



Shqipëria sot me Ramën, më e rrezikuar se në 1913, kur kërkohej copëtimi i saj!



'15 mijë euro nata në hotel'/ Ish-deputetja e PS: Rama harxhon 5 vite pension të një shqiptari në një natë



Vlora Hyseni në krye të SHISH, jo rastësi', Paloka: Synonte marrëdhëniet Kosovë-Serbi-Shqipëri, favorizohej Vuçiç

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.